



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
QENDRA PËR SHËRBSIM TË QYTYRËS  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 2877  
U. Br.

Nr. i faq. 3 Data: 09/09  
Br. nr. Datum:  
KAMENICËJA e.d.y

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



## Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 09.09.2024

Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/10, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.08.2024 miratoi këtë:

### V E N D I M

1. Me këtë Vendim bëhet shfuqizimi i pjesërishtëm i Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.
2. **SHFUQIZOHET** pika 1.2 nga Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024, si në vijim:
  - 2.1 Pika 1 paragrafi 1.2 (Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës) të Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.
3. Nga parcela e cekur në pikën 1.3 të vendimit bazë përkatësisht njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" jepen në shfrytëzim sipërfaqja prej 13183 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës, ndërsa sipërfaqja prej 19000 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme e njësisë kadastrale mbetet pronë komunale si në kopjen e planit që është në shtojcë të këtij vendimi.
4. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.
5. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Qëndresa Gagica Hajdari B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**Vendimi i`u dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;
- MAPL-së; dhe
- Arkivit.



### **Arsyetim**

Vendimi Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë përmes Procedurës së Negocimit, Në kuadër të detyrimeve tona për të siguruar përputhshmërinë e vendimeve të Komunës me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në vijim të kërkesës dhe rekomandimeve të pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kemi shqyrtuar Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me të cilin u miratua dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negocimit. Gjatë këtij procesi, është identifikuar se pika 1.2 e këtij vendimi nuk është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Koncretisht, janë vërejtur këto mangësi:

Mospublikimi në Wefaqen Zyrtare të Komunës Parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është publikuar në listën e përgjithshme dhe të veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 në webfaqen zyrtare të komunës, siç kërkohet nga neni 13 i Ligjit Nr. 06/L-092. Ky publikim është një kërkesë thelbësore për të garantuar transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës së dhënies së pronës në shfrytëzim.

Mungesa e Harmonizimit me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor Parcela e përmendur nuk është argumentuar si në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) ose Hartën Zonale, gjë që është një kërkesë ligjore sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës komunale duhet të jetë

i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe interesin publik të Komunës. Bazuar në këto mangësi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar ndërmarrjen e masave të duhura për rishqyrtimin e aktit dhe harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi. Në përputhje me këtë rekomandim kemi shfuqizuar pikën 1.2 të Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës. Ky shfuqizim është i nevojshëm për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe për të siguruar që procedura e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim të kryhet në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë. Në përfundim, shfuqizimi i pikës 1.2 të vendimit është një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të këtij akti me legjislacionin në fuqi, duke shmangur shkeljet ligjore dhe duke ruajtur integritetin e procesit vendimmarrës në Komunën e Kamenicës.